

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri,duke vendosur në çështjen juridike të paditësit D. “...” me seli në P., të cilën e përfaqësoi sipas autorizimit me shkrim avokati F. M., kundër të paditurit B. K. S. me seli në P.,për shkak të borxhit,vlera e kontestit 235,00 €, në seancën e mbajtur më datë 07.09.2015 ne prezencë të të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të të paditurit, ndërsa me datë 18.09.2015 merr këtë

A K T G J Y K I M

APROVOHET si bazuar kërkesëpadia e paditësit D. “...” me seli në P. dhe,

I.DETYROHET e paditura B. K. S. me seli në P. që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 235,00 Euro (dyqind e tridhjet e pesë euro), në emër të borxhit, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET e paditura B. K. S. me seli në P. që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 539.00 euro,në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,pas marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Paditësi D. “...” me seli në P. ka paraqitur padi me datë 14.08.2014 pranë kësaj Gjykate,kundër të paditurit B. K. S. me seli në P. duke kërkuar që t’ia paguaj në emër të borxhit shumën prej 235,00 Euro,njëherit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës,dhe pas administrimit të të gjitha provave ta aprovon kërkespadin në tërësi si të bazuar.

Lidhur me këtë çështje juridike Gjykata duke u bazuar në nenin 409 pargarfi 2 dhe neni 423 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës mbajti seancën përgaditore dhe kryesore , në mungesë të të padituri pasi që e njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe se arsyetimin e të paditurit gjykata nuk e morë parasysh për shkak se një herë nga ana e gjykatës ju dha mundësia për shtyrjen e seancë, e po ashtu për të njëjtë arsye nuk është e lejuar shtyrja e seancës ashtu siq parashihet në nenin 438 pika 2 të LPK-së, e për më tepër gjykata nuk e ka për detyrim dhe është në pamundësi që veprimtarinë e vetë t’ia përshtat agjenteve ose orarëve të palëve në procedurë.

Paditësi gjatë seancës përgatitore, seancës së mbajtur kryesore dhe në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadiisë duke kërkuar nga Gjykata që ta detyroi të paditurën në emër të borxhit t’ia paguaj shumën e përgjithshme në vlerë prej 235,00 euro,sipas provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës ku rezulton se paditësi e ka bërë rregullimin e veturës për palën e dëmtuar “instituti i avokatit të popullit”.Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi e dates 31.03.2015 , ka theksuar se e konteston padinë dhe kërkesëpadinë dhe i propozon gjykatës ta refuzoj si të pa bazuar me arsyetimin se e paditura ka

paraqitur njoftimin per revokimin e autorizimit të datës 04.03.2014 me nr.të protekolit 21/2014 lidhur me kompanin e servistit "A.".Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Gjykata gjatë shqyritimit kryesor të kësaj çështje juridike ka administruar këto prova: autorizimin për kompenzimin e servistit "A.",fatura me nr.015/4 e datës 03.03.2014,lexohet ujdia jashtëgjyqësore e datës 04.03.2014,njoftimi dhe kërkesa për anulimin e autorizimit te dt.04.03.2014, vendimi 07.03.2014,ujdia jashtëgjyqësore e dt.23.05.2014 si dhe transferi bankar i të paditurit.

Pas shqyrtimit,analizimit dhe vlerësimit të këtyre provave dhe pretendimeve të dy palëve në procedurë Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar .

Nga fatura 015/4 e datës 03.03.2014, u vërtetua fakti se paditësja kishte bërë rregullimin e veturës Hyndai Sanataf me nr të regjistrimit *numri i targave...* dhe për këtë i kishte dërguar të paditurës faturat të cilat kapin shumën e përgjithshme prej 235,00 €. Poashtu faturat përmbajnë përshkrimet lidhur me riparimin e veturës ,si dhe shumën e përgjithshme .

Nga marveshja gjyqësore e dt.04.03.2014 gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri është pajtuar që në emër të zhdëmtimit t'ia paguaj të dëmtuarit –paditësit shumën prej 235.00euro poashtu kjo marveshje jashtëgjyqësore është e nënshkruar nga të dy palët në procedurë.

Nga provat e administruara si më sipër,rezulton se paditësja ka kryer obligimet ndaj të paditurës, duke ia dërguar faturat për riparimin e veturës, e poashtu edhe me marveshje jashtëgjyqësore palët në procedurë janë dakorduar për shumën prej 235.00euro , ndërsa e paditura edhe për kundër faktit të kryerjes së punëve lidhur me riparimin e veturës, nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditëses sipas fatures dhe marveshjes së kryer.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e përfaqësuesit të së paditurës se ka paraqitur njoftimin për revokimin e autorizimit e datës 04.03.2014 me nr të përtokolit 21/2014 lidhur me paditësin ,gjykata e konsideroj si të pabazuar sepse njoftimi dhe aktvendimi për revokimin e autorizimit nga e paditura është bërë me datën 07.03.2014 qka do të thot se pas kryerjes së riparimit të veturës dhe pasi arritjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore e dt 04.03.2014 .Ndërsa pretendimi tjetër të të paditurës lidhur me provat të cilat i ka dorëzuar me përgjigje në padi për gjykatën janë irelevante sepse marveshja e dt.23.05.2014 dhe transferin bankar nuk janë objekt i këtij kontesit .

Bazuar në të lartcekurat gjykata duke iu referuar nenit 7 dhe 8 të LMD-së, të cilët parashohin se palët kontraktuese në marrëdhënie detyrimore kontraktuese janë të detyruara ti kryejnë detyrimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke, andaj gjykata në bazë të këtyre dispozitave ka vlerësuar se ekziston detyrimi i të paditurës për pagesën e borxhit në shumën e gjykuar.

E paditura, duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e faturës 015/4 e dt.03.03.2014 dhe marrëveshjes së datës 04.03.2014 të pranuar nga palët në procedurë, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit.

Sipas nenit 245 të LMD-së, kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartëcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumën e gjykuar.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, duke aprovuar shumën e përgjithshme prej 539,00 euro, në emër të padis shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës për aktgjykim në shumë prej 15.00euro, për taksën në padi 15.00euro, për tri seanca të mbajtura për secilën seancë shumën prej 135,00 euro.

Andaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-

III.C.nr. 443/2014 të dt.18.09.2015

G j y q t a r j a
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.